



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 28 maj 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaçku, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje morën pjesë: Isa Krasniqi, kryeshefi i Agjencisë të Statistikave të Kosovës, Zyra e KE-së, OSBE, KCSF, INPO, Ekonomia Online, KosovaPress.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-043 për lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor i statistikave zyrtare, për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me heqjen pikës së tretë nga rendi i ditës, me arsyetimin se Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa e ka në procedurë për shqyrtim Projektligjin për Institucionet mikrofinanciare. Komisioni ka vendosur që bashkë me Komisionin për Buxhet dhe Financa të mbajë mbledhje të përbashkët, në të cilën do të shqyrtohen të dy projektligjet me qëllim të hartimit dhe harmonizimit të amendamenteve dhe evitimit të ndonjë kolizionit eventuale.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i statistikave zyrtare, për vitin 2017;

Nait Hasani, njoftoi komisionin se Raporti vjetor për ASK-në është raport që përmban të dhënat për punën e institucionit, për vitin 2017 dhe paraqet të dhëna për statistikave zyrtare të Kosovës.

Isa Krasniqi, kryeshef i ASK-së, gjatë paraqitjes së raportit, tha se ASK-ja ka një vlerësim ndërkombëtar nga Eurostat-i, bazuar në pesëmbëdhjetë parimet e kodit për statistikave zyrtare, të cilat parime janë matje e vlerësimeve edhe nga shtetet e tjera të Bashkimit Evropian.

Vlerësimet nga Eurostat-i janë një arritje për Agjencinë e Statistikave të Kosovës, për arsye se dëshmon funksionimin e ASK-së sipas standardeve evropiane.

Gjithashtu, ai e njoftoi komisionin për rezultatet, performancën dhe projektet që ASK-ja ka realizuar nga Komisioni Evropian, çka nënkupton se Kosova si shtet ka hy në proces me hapat e vendeve evropiane.

Nait Hasani, kërkoi nga përfaqësuesi i ASK-së, të dhënat për natalitetin dhe mortalitetin në Kosovë edhe në baza etnike, të cilat janë të shënuara në raport.

Shqipe Pantina, pyeti, a ka ende probleme ASK-ja, me institucione të cilat hezitojnë të japin të dhëna ASK-së dhe pse Këshilli i ASK-së ka pushuar punën, a ka këshilli mandat?

Isa Krasniqi, u përgjigj, se Këshilli është pa mandat dhe pritet që me ligjin e ri, të konstituohet këshilli i ri edhe me dy anëtarë dhe të fillojë funksionimin sipas rregullores së punës së ASK-së, ndërsa sa i përket të dhënave për natalitetin dhe mortalitetin, të dhënat inkorporohen në sistem sipas qendrës së regjistrimit civil dhe të dhënave që marrin nga spitalet e Kosovës, për të dhënat në baza etnike ASK-ja dërgon pyetëtorin për të dhënat.

Konstatim: Komisioni, pas diskutimeve, njëzëri e miratoi raportin dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Statistikave Zyrtare, për vitin 2017.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 7.2.8 të Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikave Zyrtare të Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës ia paraqet, përmes Kryeministrit, për miratim Qeverisë dhe Kuvendit raportin mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 28.5.2018, shqyrtoi Raportin vjetor të Statistikave Zyrtare, për vitin 2017 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 7.2.8 të Ligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:30.

**E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.**

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani